

UDHËZIM
Nr. 23, datë 1.8.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, “PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në pikat 6, 8, 9 dhe 10 të kreut IV/3, të udhëzimit nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, togfjalëshi “kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it” zëvendësohet me togfjalëshin “afateve të përcaktuara nga vetë IAL-të”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi